



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 896/4 prot.

Datë 18.05.2023

V E N D I M
Nr. 398/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.05.2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-66562-04-19-2023, me objekt: Loti 5 “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Fier”, me fond limit 21.673.080 lekë (pa tvsh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 22.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Ankimues: Operatori ekonomik “NRG” SHPK
Farkë, Rruga “Eduart Mano”, Pallatet Nr.10, Kopshti Zologjik, Selitë, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nd.1, 1001, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,

Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.04.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-66562-04-19-2023, me objekt: Loti 5 “*Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Fier*”, me fond

limit 21.673.080 lekë (pa tvsh), parashikuar për t'u zhvilluar në datë 22.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 26.04.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 896 prot., e operatorit ekonomik “NRG” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me anë të shkresës nr. 617/4 prot., datë 03.05.2023, protokolluar me tonën me nr. 896/2 prot., datë 05.05.2023 me objekt *“Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim dezinfektimi”, ndarë në 6 (gjashtë) Lote”*, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Publik informacion në lidhje me procedurën e prokurimit, si dhe bashkëlidhur ka dërguar aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, me nr. 616/2 prot., datë 02.05.2023, me objekt *“Vendim mbi shqyrtimin e ankesës së ankimuesit “NRG” SHPK”*, ku konstatohet se e ka pranuar pjesërisht atë, si më poshtë:

“[...]”

Operatori ekonomik, “NRG” SHPK ka ankimuar kriterin e përcaktuar në pikën 1, të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik”, në dokumentat e tenderit, me pretendimin si vijon: “Kërkojmë që ky kriter të modifikohet sipas pikës 3 të nenit 41 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar. [...]

Bazuar në sa më sipër, KSHA gjykon se duhet të kryhet modifikimi i kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1, duke riformuluar kriterin kualifikues lidhur me dokumentacionin e kërkuar për përvojën e mëparshme të ngjashme të realizuar me sektorin publik, duke e lënë atë opsional dhe duke i dhënë mundësinë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm për paraqitjen lidhur me dëshminë e përvojës së mëparshme në format e përcaktuara në VKM 285/2021.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues lidhur me këtë pikë pranohet.”

II.5. Në datën 09.05.2023, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin nr.348/2023, datë 09.05.2023, ku vendosi:

- 1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-66562-04-19-2023, me objekt: Loti 5 “Shërbim Dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Fier”, me fond limit 21.673.080 lekë (pa tvsh), parashikuar për t'u zhvilluar në datë 22.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.*
- 2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.*

3. *Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues *“Edhe pse LPP dhe RrPP kanë përcaktuar qartë se çfarë dokumentacioni duhet të kërkojë, Njësia e Hartimit të Dokumentave të tenderit nuk ka përcaktuar kritere për të vërtetuar kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë dhe konkretisht:*

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”, Kërkojmë që autoriteti kontraktor të shtojë si kritere të domosdoshme dhe ligjore kriteret e kualifikimit për:

- licensën profesionale për realizimin e shërbimeve të OE,*
- drejtuesin teknik dhe specializimin që duhet të ketë ky i fundit;*
- Fuqinë punëtore dhe certifikatat e tyre profesionale,*
- mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën;*

Sjellim në vëmendjen e autoritetit kontraktor se në dokumentat e tenderit të herës së kaluar të gjitha këto dokumenta ishin përcaktuar si kritere kualifikimi, pavarësisht se Komisioni i Prokurimit Publik vendosi modifikimin dhe jo heqjen e tyre, modifikim i cili nuk u bë pasi procedura e prokurimit u anulua.

Ajo që bie në sy është qëndrimi ekstremisht i kundërt i autoritetit Kontraktor i cili në procedurën e parë të prokurimit kishte kërkuar kritere kualifikimi (megjithëse të ekzagjeruara) kurse në

procedurën konkrete nuk ka kërkuar fare kritere kualifikimi teknike dhe profesionale duke e vlerësuar këtë shërbim një shërbim të rëndotë (kur është një shërbim shumë i rëndësishëm me impakt në mjedis, në jetën dhe shëndetin e popullatës apo në florën dhe faunën) i cili mund të kryhet nga cdo operator ekonomik (edhe po nuk patën licensë profesionale, apo drejtues teknik, apo nuk disponojnë fare personel teknik dhe rrjete apo pajisje në pronësi apo me qera).

Si do të bindet Autoriteti Kontraktor që një operator ekonomik është i aftë të realizojë këtë shërbim me cilësinë e kërkuar dhe brenda afateve kur nuk ka kërkuar asnjë dokument kualifikues për tu bindur se ai ka aftësinë teknike dhe profesionale të realizojë shërbimin e kërkuar?!

Në kriteret e veçanta të kualifikimit nuk është kërkuar paraqitja e Formularit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe Formularit të Listës së Shërbimeve sipas Shtojcës 2 prandaj kërkojnë që të slitohet tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit pika 1 edhe paraqitja e këtyre dy Forinilareve (ashtu sikurse është kërkuar paraqitja e Formularit Përmbledhës së Vetdeklarimit sipas Shtojcës 9 dhe Sigurimi i Ofertës sipas Shtojcës 3).

[...] Referuar procedurës konkrete, konstatojmë se blerja e mallit nga subjektet të cilat ofrojnë shërbimin objekt prokurimi, ka një rregullim të posacem ligjor dhe kryhet sipas disa procedurave specifike, duke u shoqëruar me dokumentacion përkatës, për vendosjen e tyre në treg (Ligji 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik” dhe rregullat në zbatim të tij).

Sa më sipër, referuar Ligjit 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik” dhe rregullat në zbatim të tij, produktet për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi, pajisen me dokumentacion përkatës për vendosjen e tyre në treg në Republikën e Shqipërisë dhe duke qenë se për këtë procedurë ka një rregullim specifik, autoriteti kontraktor duhet të kërkojë për këto produkte dokumentacion shoqërues si i parashikon ligji i posaçëm.

Në specifikimet teknike AK citon “Produktet Biocide autorizohen në vendin tone sipas VKM nr 933 datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”.

VKM nr. 933 datë 25.11.2020 e cila parashtron qartë dhe pastër çfarë dokumentacioni duhet të plotësoi një operator ekonomik për matjen e lejes së importit të produkteve biocide nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale. Në bazë të VKM nr. 933 datë 25.11.2020, operatori ekonomik duhet të paraqesë pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale dokumentet si më poshtë:

- Leter aksesit për lëndën aktive e regjistruar në ECHA
- Një përmbledhje të karakteristikave të produktit biocid e cila mund të shkarkohet nga ECHA (ku përfshihen karakteristikat, habitatet e synuara, dozat e përdorimit, etj).
- Leter aksesit për produktin e regjistruar në ECHA
- Autorizim prodhuesi
- Etiketen në gjuhën Shqipe dhe të origjinës
- MSDS në gjuhën shqipe dhe në gjuhën e origjinës

- Certifikat rregjistrimi ne Europe, Kanada ose ne USA ne gjuhen Shqipe dhe te origjines
Për sa i përket pjesës teknike dhe zgjedhjes së produkteve, referenca tek VKM 933 date 25.11.2020 është e qartë, pra se si përbërësi aktiv ashtu edhe formulimi (produkti biocid) duhet të jene të regjistruara në ECHA, (Agjencia Evropiane e Kimikateve).

Ligji i 95/2015 parashikon mundësinë e regjistrimit në Republikën e Shqipërisë të produkteve që janë të regjistruara ne vende si Bashkimi Evropian, Zvicër, SHBA, Kanada, Japoni, Turqi, Izrael dhe Australi dhe në tender del qartë se, këto biocide duhet të jen të autorizuar në ECHA, por nuk është e qartë nëse vlera e autorizimit në ECHA nbizotëron mbi atë të vendit të origjinës nga i cili është paraqitur autorizimi. Me fjalë të tjera, në rast mospërputhjeje midis parametrave teknikë të aplikimit, përdorimit, habitateve të synuara, qëndrueshmërisë, shpeshhtësisë së ndërhyrjeve, dozave, vlerësimeve të biocidit ose lëndëve aktive të regjistruara nga Agjencia Evropiane ECHA, të cilat mund të gjenden ne:

- 1) Faqja e detajeve të rregjistrimit në ECHA
- 2) Raportin e rregjistrimit në ECHA
- 3) Përmbledhjen e karakteristikave te produktit biocid

apo do konsiderohen të dhënat e rregjistrimit që i përket vendit të origjinës, të paraqitura në fazën e aplikimit për rregjistrimin në Shqipëri (për shembull EPA Amerikane) ose DE (Departamenti Australian i Mjedisit) etj?? **Kerkojmë sqarime në lidhje me këtë pikë.**

Në listën e përbërësve aktivë të përdorshëm nuk përcaktohet doza MINIMUM që do te përdoret ne bazë të sipërfaqes, por vetëm se rezultati pozitiv i shërbimit duhet të jetë kontrolli 100% i larvave, edhe këtu lind një problem në lidhje me përdorimin e dozën minimale, e cila duhet përcaktuar

Për këtë duhet ti rreferohemi autorizimit/rregjistrimit në ECHA apo madje mund të shkojë shumë më poshte dozës minimale të autorizuar në ECHA, nëse kjo është e ndryshme nga doza e autorizuar në vendin nga i cili vjen rregjistrimi?? **Kerkojmë sqarime në lidhje me këtë pikë.**

Sa më sipër kerkojmë që të shtohet si kriter i detyrueshëm kualifikues, sipas V.K.M. nr. 933 datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg” paraqitja e dokumentacionit:

- Autorizim prodhuesi ose Leje Importi.
- MSDS ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhen e origjines.
- Certifikat rregjistrimi ne Europe, Kanada ose ne USA ne gjihten Shqipe dhe te origjines.
- Produkti te jetë i përfshirë në bazën e të dhënave të Agjencisë Evropiane të Kimikateve për produktet biocide të autorizuar.

Autoriteti kontraktor duhet të parashikojë në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kriteret kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik dhe profesional, por edhe kriteret të tiera kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimit të specifikimeve teknike të produkteve.

Synimi bazë i autoritetit kontraktor duhet të jetë vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës.

Për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor duhet të parashikojë në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kriteret kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik dhe profesional, por edhe kriteret të tjera kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësisë së specifikimeve teknike të produkteve.

Në interpretim të dispozitave ligjore të fushës së prokurimit, vlen të theksojmë se së pari, ligjvënësi ka parashikuar dy natyra kriteresh kualifikimi, kriteret të cilat përcaktohen me ligj, si dhe kriteret dhe kërkesat të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në përputhje me llojin, volumnin, sasinë, specifikat e shërbimit që kërkohet të prokurohet, me qëllim realizimin me sukses dhe cilësi të tij.

Vendosja e këtij kriteri është e domosdoshme pasi DT të hartuara në këtë mënyrë nuk përcaktojnë qartë momentin se kur duhet që O.E. të dorëzojnë dokumentacionin në lidhje me produktin përpara Autoritetit Kontraktor. Në eksperiencat e viteve të kaluara ka patur raste të futjes së produkteve jo-cilësorë kontrabandë që natyrisht nuk ofronin cilësinë e duhur.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, për Lotin 5, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar këto kriteret:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 1.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit 5**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.
- 2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet

i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e publikimit të njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit të Lotit 5**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
 - b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Shënim: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1), të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në atë Lot ku oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

III.1.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.3. Në nenin 77, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu

referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.4. Referuar aktit të trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues me nr.612/2 prot., datë 02.05.2023, konstatohet se autoriteti kontraktor ka refuzuar pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues me argumentin se “...KSHA gjykon, se këto pretendime në thelb kanë të bëjnë me shtim të kriterëve të kualifikimit dhe jo me pretendime për modifikimin e kriterëve diskriminuese, të cilat do të shkaktonin skualifikim të padrejtë nga procedura e prokurimit. KSHA gjykon, se objekti i ankesës së operatorit ekonomik nuk lidhet me kundërshtimin e një kriteri të caktuar të përcaktuar në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, por mbi shtimin e kriterëve të kualifikimit, e si rrjedhojë përcaktimi i kriterëve të kualifikimit sipas kërkesës nga ankimuesi, konsiderohen kritere të reja që do të rëndonin pozitat e operatorëve ekonomikë të interesuar. Në rastin konkret, KSHA gjykon, se njësia e prokurimit si dhe autoriteti kontraktor përfitues ka parashikuar kriteret dhe specifikimet teknike minimale, të gjykuar të nevojshëm për vërtetimin e plotësimit të kapacitetit teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për realizimin me sukses të kontratës objekt – prokurimi.

Sa më sipër, KSHA gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar, se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës bazuar në pikën 1, të nenit 94, të VKM-së 285/2021 [...]. Sa më sipër, KSHA në asnjë rast nuk mund të marrë kompetencat e njësisë së prokurimit dhe

autoritetit kontraktor përfitues duke shtuar kriteret kualifikimi në një procedurë të prokurimit publik.”

III.1.5. KPP gjykon se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike (neni 24 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (neni 21 i LPP-së) dhe njëherazi përgjegjës për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 110 pika 1 të LPP-së, parashikohet se *“Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”*. KPP gjykon se, që të justifikohet ligjërisht kërkitimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuar (legjitimitimi pasiv), duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e organit administrativ për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt, ose veprimeve, pra operatori ekonomik ankimues duhet të provojë se interesi i tij i ligjshëm është cenuar nga vendime dhe veprime konkrete (reale) të autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizmat ligjorë për kundërshtimin e kriterëve për kualifikim pranë këtij të fundit, duke dhënë garanci të plota operatorëve ekonomikë ankimues se procedurat për fitimin e kontratave publike, do të nënshtrohet kushteve specifike, të cilat duhet të përmbushin parakushtin të parashikuar nga neni 77 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Kuadri ligjor në fuqi, ka paraparë pozitën juridike të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ i shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të shprehura me akte administrative (dokumentet e procedurës së prokurimit), duke i dhënë të drejtën ligjore të shprehet mbi kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike në rast se këto të fundit janë hartuar në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe kuadrin ligjor sektorial në fuqi që rregullon kontratën objekt-prokurimi. Kompetenca e mësipërme është shprehur në disa drejtime në ligjin për prokurimin publik në fuqi, ku nën nenin 118 pika 2 gërma “b” të lex specialis parashikohet se ndër kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik, janë ato të anulimit, plotësisht ose pjesërisht, të një veprimi ose vendimi të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato kriteret kualifikimi ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj.

Në rastin konkret, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, KPP gjykon se nuk ndodhet ne kushtet ku duhet të gjykojë mbi pretendime për heqjen apo modifikimin e kriterëve të kualifikimit, apo të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (njësisë së prokurimit) të shtojë kriteret kualifikimi në një procedurë të prokurimit publik, por në rastin konkret KPP duhet të gjykojë mbi respektimin e parimeve kryesore të prokurimit publik, të cilat duhet të respektohen nga autoriteti kontraktor në hartimin e dokumentave të tenderit në një procedurë prokurimi.

Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, konstatohet se autoriteti kontraktor ka kërkuar kritere minimale për kualifikimin e operatorëve ekonomikë.

Referuar ligjit të prokurimit publik, në nenin 3 të tij, parashikohen parimet kryesore të cilat duhet të respektohen nga autoriteti kontraktor gjatë të gjitha fazave të zhvillimit të një procedure prokurimi, ku çdo autoritet kontraktor dhe entet kontraktore duhet të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

Në interpretim të dispozitave ligjore të fushës së prokurimit, vlen të theksojmë se së pari, ligjvënësi ka parashikuar dy natyra kriteresh kualifikimi, kritere të cilat përcaktohen me ligj, si dhe kritere dhe kërkesa të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në përputhje me llojin, volumin, sasinë, specifikat e shërbimit që kërkohet të prokurohet, me qëllim realizimin me sukses dhe cilësi të tij. Kriteret e përcaktuara me ligj mund të parashikohen nga ligji për prokurimin publik dhe rregullat në përputhje me të, gjithashtu mund të përcaktohen kritere të cilat bazohen në ligje specifike, në varësi të fushës apo objektit që kërkohet të realizohet.

Gjithashtu, Komisioni konstaton se në rastin konkret, qëllimi përfundimtar i autoritetit kontraktor është kryerja e shërbimit të dezinfektimit në zonat bregdetare dhe urbane.

Në nenin 5 të Ligjit nr.10/081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se *“Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.”*

Ndërkohë, në nenin 6 të ligjit parashikohet se *“Ushtrimi i një veprimtarie apo kryerja e një veprimi nëpërmjet licencimit apo, përkatësisht, autorizimit bëhet vetëm nëse plotësohen këto dy rrethana:*

a) ushtrimi i veprimtarisë apo kryerja e veprimit në mënyrë të parregullt mund të cenojë jetën, shëndetin, të drejtat e interesat e ligjshëm të shtetasve, sigurinë e rendin publik, sigurinë kombëtare, konkurrencën e ndershme apo mirëfunksionimin e tregut, një të mirë publike, objektivat sociale dhe çdo interes tjetër publik të kësaj natyre;

b) garantimi i përshtatshëm i interesave të përcaktuar në shkronjën “a” të këtij neni, pavarësisht ekzistencës së rregullave, të standardeve e mekanizmave vlerësues, vëzhgues dhe ndëshkues të mëposhtëm, nuk mund të arrihet pa një proces vetëdeklarimi, shqyrtimi, inspektimi e vlerësimi të përmbushjes së disa kriterëve të paracaktuara, përpara fillimit të veprimtarisë apo të kryerjes së veprimit.”

Ndërsa referuar VKM Nr.538, datë 26.5.2009 *“Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës Kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera Nënligjore të përbashkëta”*, në Aneksin 1 të vendimit të mësipërm, ligjvënësi ka parashikuar: *“Kategoritë e licencave e lejeve që si rregull trajtohen nga ose nëpërmjet qkl-së”*, ku konstatohet se; *“Veprimtaritë që kryejnë “shërbime të tjera shëndetësore ose higjiëno-sanitare” janë ato të përcaktuara në kategorinë II.8 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. Veprimtaritë e kësaj kategorie ndahen në dy nënkategori si vijon: a) “shërbime ekspertize higjiëno-shëndetësore” me kodin II.8.A; dhe b) “shërbime ndërhyrëse higjiëno-shëndetësore” të tilla dezinfektimi, deratizimi, dizensektimi dhe të tjera të këtij lloji me kodin II.8.B.”* Pra, shoqëritë të cilat kryejnë veprimtari shërbime ndërhyrëse higjiëno-shëndetësore të tilla si dezinfektimi, deratizimi, dizensektimi dhe të tjera, duhet të pajisjen më licencë përkatëse duke plotësuar disa kushte specifike.

Referuar procedurës konkrete objekt-shqyrtimi, konstatojmë se blerja e mallit nga subjektet të cilat ofrojnë shërbimin objekt-prokurimi, ka një rregullim të posaçëm ligjor dhe kryhet sipas disa procedurave specifike, duke u shoqëruar me dokumentacion përkatës, për vendosjen e tyre në treg (Ligji 95/2015 *“Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”* dhe rregullat në zbatim të tij).

Në vijim referuar nenit 77 të Ligjit 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, përcaktohet se *kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë të cilat duhet të bazohen në a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; dhe c) aftësinë teknike dhe profesionale [...]*.

Sa më sipër, referuar këtij neni, autoritetit kontraktor i është lënë në diskrecion vendosja e kriterëve të kualifikimi për një procedurë prokurimi, por nga ana tjetër qëllimi i ligjit të prokurimit publik nuk është shmangia apo e drejta absolute e autoritetit kontraktor për të mos vendosur asnjë kriter kualifikimi, fakt ky i cili do të shkaktonte shtrembërim të konkurrencës. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Gjithashtu, nisur nga natyra, lloji i veçantë i kësaj procedure prokurimi, si dhe ndikimi dhe ndjeshmëria e lartë që kjo procedurë ka drejtpërdrejtë në jetën e njerëzve, gjykojmë se autoriteti kontraktor duhet të hartojë me përgjegjësi të veçantë, brenda diskrecionit të dhënë nga ligji, kriteret e veçanta të kualifikimit, me qëllim që të sigurohet që ky shërbim do të ofrohet nga subjekte të cilat zotërojnë të gjitha kapacitetet e nevojshme njerëzore, profesionale, teknike, e që rrjedhimisht do të sillnin realizimin me sukses dhe pa dëme njerëzore të këtij shërbim sensitiv. Autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të vendosur kriteret minimale të kualifikimit, por kjo duhet të jetë në proporcion me llojin dhe natyrën e procedurës së prokurimit.

Qëllimi i kushteve të përzgjedhjes (kualifikimit) është identifikimi i atyre operatorëve ekonomikë që janë të aftë të kryejnë dhe plotësojnë kontratën që do të fitohet. Autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë kërkesat që janë të barabarta për të gjithë operatorët ekonomikë. Kur vendos kushtet për pjesëmarrje, autoriteti kontraktor mund të përcaktojë nivelet minimale të kapacitetit që operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë, kur është e përshtatshme, duke përfshirë kapacitetet e palëve të treta. Këto kushte duhet të jenë të lidhura dhe proporcionale me objektin e prokurimit. Prosesi i përzgjedhjes duhet të kufizohet në një vlerësim, nëse arsyet për përjashtim (të detyrueshme ose fakultative) janë përmbushur, si dhe një vlerësim të përshtatshmërisë së operatorit ekonomik për të kryer shërbimin, gjendjes së tij financiare dhe ekonomike, si dhe kapacitetit të tij teknik dhe/ose profesionale.

Prokurimi publik është një ndër veprimtaritë kryesore të shtetit, ndaj jo rastësisht ligjvënësi ka parashikuar edhe 6 qëllime kryesore të ligjit: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Në parimet e përgjithshme të ligjit për prokurimin publik është parashikuar, si një risi e re në ligj edhe detyrimi i autoriteteve kontraktore që të shmangin cdo formë artificiale për të ngushtuar konkurrencën. Në kuptim të ligjit, konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

Në interpretim teologjik (qëllimit të normës juridike), KPP gjykon se konkurrenca konsiderohet e ngushtuar edhe duke favorizuar në mënyrë të padrejtë një operator apo grupe operatorësh ekonomikë të caktuar ose duke dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. Në të dy format, shtrëmbërimi i konkurrencës mund të vijë edhe si pasojë e kriterëve të veçanta të kualifikimit jo proporcionale me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit, por mund të vijë edhe **me mungesë të plotë të kriterëve** dhe kushteve të garës në një procedurë prokurimi.

Gjithashtu, KPP sjell në vëmendje se në rastin konkret nuk duhet të harrojmë se ndër qëllimet e rëndësishme të ligjit është ajo e mirëpërdorimit të fondeve publike. Një ndër elementët e arritjes së mirëpërdorimit të fondeve publike është edhe përmes nxitjes së konkurrencës dhe trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues për operatorët ekonomikë.

Për të garantuar përmbushjen e qëllimeve të ligjit për prokurimin publik, ligjvënësi ka parashikuar një sërë garancish procedurale për autoritetin kontraktor duke parashikuar si kritere të përgjithshme të kualifikimit (neni 76 i ligjit) ashtu edhe ato të vecanta (neni 77 i ligjit). Gjithashtu ligjvënësi ka parashikuar edhe kriteret përcaktimit të ofertës fituese në nenin 87 të ligjit. Pra, thënë ndryshe, ligjvënësi ka parashikuar një sërë garancish procedurale në procedurën e prokurimit, si për autoritetet kontraktore, ashtu edhe për operatorët ekonomikë, të cilat në thelb garantojnë si nxitjen e konkurrencës, por gjithashtu edhe të mirëpërdorimit të fondeve publike.

Qëllimi i vendosjes së kriterëve të vecanta të kualifikimit është në thelb garancia procedurale e autoritetit kontraktor se kontrata publike do të zbatohet nga një operator ekonomik që disponon kapacitetin teknik, ekonomik, profesional dhe ligjor duke shmangur çdo dyshim paraprak për dështimin e realizimit të saj.

Gjithashtu përcaktimi i kushteve dhe kriterëve të qarta lidhet ngushtësisht edhe me parimin e transparencës në një procedurë prokurimi. *Inter allia dhe mutatis mutandis* në çështjen C-42/13, datë 6 Nëntor 2014, Cartiera dell'Adda, paragraphs 42 deri 44, GJED shprehet “*Gjykata ka vendosur tashmë se autoriteti kontraktor duhet të respektojë në mënyrë rigoroze kriteret që ai ka vendosur vetë, në mënyrë që t'i kërkohej të përjashtojë nga kontrata një operator ekonomik i cili ka dështuar të sigurojë një dokument ose informacion të cilin i është kërkuar të paraqesë sipas kushtet e përcaktuara në dokumentacionin e kontratës, për kushtet e përjashtimit (shih, në këtë kuptim, vendimin në Manova, C 336/12, EU:C:2013:647, paragrafi 40)*

Kjo kërkesë strikte nga ana e autoriteteve kontraktore e ka origjinën në parimin e trajtimit të barabartë dhe detyrimin e transparencës që rrjedh nga ky parim, të cilit këto autoritete i nënshtrohen në përputhje me nenin 2 të Direktivës 2004/18.

Së pari, parimi i trajtimit të barabartë kërkon që ofertuesve t'u ofrohet mundësia e barabartë kur formulojnë ofertat e tyre, gjë që rrjedhimisht nënkupton që ofertat e të gjithë ofertuesve duhet t'u nënshtrohen të njëjtave kushte. **Së dyti, detyrimi i transparencës synon të përjashtojë çdo rrezik favorizimi apo arbitrariteti nga ana e autoritetit kontraktor.** Ai nënkupton që të gjitha kushtet dhe rregullat e detajuara të procedurës së dhënies së kontratës duhet të përcaktohen në mënyrë të qartë, të saktë dhe të qartë në njoftimin e kontratës ose specifikimet, në mënyrë që, së pari, të gjithë ofertuesit e informuar në mënyrë të arsyeshme që ushtrojnë kujdes të zakonshëm të mund të kuptojnë rëndësinë e tyre të saktë dhe të interpretojnë ato në të njëjtën mënyrë dhe, **së dyti, autoriteti kontraktor është në gjendje të konstatojë nëse ofertat e paraqitura plotësojnë kriteret që zbatohen për kontratën në fjalë (shih, në këtë kuptim, vendimin në Komisionin kundër CAS Suçhi di frutta, C 496/99 P., EU:C:2004:236, paragrafët 10”).**

Sigurisht, Komisioni i Prokurimit Publik shfaqet në cilësinë e një organi quasi gjyqësor, i krijuar në përputhje me Direktivën 89/665 datë 21 dhjetor 1989, krijuar me ligj për të mbrojtur interesin

e ligjshëm të operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi. KPP në asnjë rast nuk mund të marrë tagrat e hallkave të tjera zhvilluese të procedurës së prokurimit si njësi e prokurimit dhe të përcaktojë kriteret kualifikimi apo të shtojë kriteret kualifikimi një vendimarrje e konsoliduar në vite në qëndrueshmëri nga ana e këtij Komisioni. Por, një ndër parimet kryesore në vendimarrjen e KPP-së, saksionuar nga ligji, nga kodi i procedurave administrative është edhe ai i objektivitetit. Neni 14 i KPRA parashikon se *“Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe i japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative”*. Në rastin konkret, nuk duhet të shmanjim nga vendimarrja faktin se procedurat e dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimit janë mbi të gjitha masa parandaluese dhe kontrolluese të sëmundjeve infektive në përputhje me nenin 33 të Ligjit Nr.10138, datë 11.05.2009 *“Për shëndetin publik”*.

Gjithashtu, duke qenë se procedura e prokurimit objekt ankimi është një procedurë mbi kufirin e lartë monetar, rrjedhimisht lindin detyrime të parashikuara nga direktivat europiane për fushën e prokurimit publik, të cilat janë transpozuar edhe nga Ligji për Prokurimin Publik. Konkretisht, në Nenin 58 pika 5 të direktive 24/2014, parashikohet se *“Autoritetet kontraktore do të përcaktojnë kushtet e kërkuara të pjesëmarrjes, të cilat mund të shprehen si nivele të aftësive minimale, së bashku me mjetet e duhura provuese, në njoftimin e kontratës ose në ftesën për të konfirmuar interesin.”* Pra, edhe sipas direktivës europiane, përcaktohet se autoritetit kontraktore duhet të përcaktojnë në njoftimin e kontratës apo ftesën për ofertë kërkesat për kualifikim së bashku me mjetet provuese të tyre.

Gjithashtu, *Inter alia dhe mutatis mutandis* në Çështjen C-496/99 Komisioni kundër Suçhi di Frutta SpA [29 Prill 2004], paragrafi 111 *“Parimi i transparencës, i cili është pasojë e tij, synon në thelb të përjashtojë çdo rrezik favorizimi ose arbitrariteti nga ana e autoritetit kontraktor. Ai nënkupton që të gjitha kushtet dhe rregullat e detajuara të procedurës së dhënies së kontratës duhet të hartohen në mënyrë të qartë, të saktë dhe të qartë në njoftimin ose dokumentet e kontratës në mënyrë që, së pari, të gjithë ofertuesit e informuar në mënyrë të arsyeshme që ushtrojnë kujdes të zakonshëm të mund të kuptojnë rëndësinë e tyre të saktë dhe të interpretojnë ato në të njëjtën mënyrë dhe, së dyti, autoriteti kontraktor është në gjendje të konstatojë nëse ofertat e paraqitura plotësojnë kriteret që zbatohen për kontratën përkatëse”* dhe paragrafi 115 *“Në këtë sfond, rrjedhimisht i takon Komisionit, në cilësinë e tij si autoritet kontraktor, të respektojë rreptësisht kriteret që ai vetë ka përcaktuar mbi këtë bazë, jo vetëm në procedurën e tenderit në vetvete, e cila ka të bëjë me vlerësimin e ofertave të paraqitura dhe zgjedhjen e ofertuesit të suksesshëm, por edhe në përgjithësi deri në përfundimin e fazës gjatë së cilës kryhet kontrata përkatëse.”*

Pra, referuar praktikës së mësipërme të Gjykatës Europiane të Drejtësisë, gjykojmë se, së pari, parimi i trajtimit të barabartë kërkon që ofertuesve t'u ofrohet mundësia e barabartë kur formulojnë ofertat e tyre, gjë që rrjedhimisht nënkupton që ofertat e të gjithë ofertuesve duhet t'u nënshtrohen të njëjtave kushte. Së dyti, detyrimi i transparencës synon të përjashtojë çdo rrezik

favorizimi apo arbitrariteti nga ana e autoritetit kontraktor. Ai nënkupton që të gjitha kushtet dhe rregullat e detajuara të procedurës së dhënies së kontratës duhet të përcaktohen në mënyrë të qartë, të saktë në njoftimin e kontratës ose specifikimet, në mënyrë që, së pari, të gjithë ofertuesit e informuar në mënyrë të arsyeshme që ushtrojnë kujdes të zakonshëm të mund të kuptojnë rëndësinë e tyre të saktë dhe të interpretojnë ato në të njëjtën mënyrë dhe, së dyti, autoriteti kontraktor është në gjendje të konstatojë nëse ofertat e paraqitura plotësojnë kriteret që zbatohen për kontratën në fjalë.

Akoma me tej, referuar nenit 124 të LPP “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës”, ku përcaktohet *“Autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi”*, në rastin konkret, për sa kohë autoriteti kontraktor nuk parashikon asnjë kriter kualifikimi, i cili i siguron përmbushjen e kontratës, rrjedhimisht është e pamundur mbikëqyrja e kontratës gjatë zbatimit të saj, pasi logjikisht, fituesi i kësaj procedure, nuk ka asnjë detyrim të vërtetojë me dokumentacion i cili provon ushtrimin e veprimtarisë së tij sipas ligjit të prokurimit publik apo ligjit sektorial, si dhe në asnjë moment nuk vërtetohet se ky operator i cili do të fitojë kontratën disponon kapacitetet e nevojshme profesionale, teknike për kryerjen me cilësi dhe përgjegjesi të këtij shërbimi.

Gjithashtu në një procedurë prokurimi, autoriteti kontraktor në procesin e monitorimit dhe zbatimit të kontratës nuk mund të marrë të mirëqenë se do të përfshijë automatikisht kërkesat e legjislacionit sektorial, gjatë fazës së monitorimit të kontratës, të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe GJED në vendimin C-403/21 SC NV Construct SRL *“...se parimet e proporcionalitetit dhe transparencës të garantuara nga nënparagrafi i parë i nenit 18 (1) të Direktivës 2014/24 duhet të interpretohen si pengues që dokumentet e prokurimit të plotësohen automatikisht me kriteret kualifikimi, që lindin nga ligjet e veçanta të zbatueshme për aktivitetet në lidhje me kontratën që do të jepet, të cilat nuk ishin të përcaktuara në dokumentet e prokurimit dhe të cilat autoriteti kontraktor vendosi të mos ua imponojë operatorëve ekonomikë në fjalë.”*

Ndërkohë, vlen të theksojmë se, vetë GJED në vendimin C-403/21 SC NV Construct SRL, ka konfirmuar se autoriteti kontraktor mund të përdorë kriteret të përcaktuar në legjislacionin sektorial si kriteret kualifikimi *“Në ushtrimin e kësaj diskrecioni të gjerë, autoriteti kontraktor mund të vendosë të përfshijë, midis kriterëve të përzgjedhjes të përmendura në njoftimin e kontratës ose specifikimet e tenderit, detyrimet sipas ligjeve të veçanta të zbatueshme për aktivitetet që mund të kërkojnë të kryhen në kontekstin e realizimit të kontratës publike dhe që nuk kanë rëndësi të madhe.”*

Gjithashtu, vlen të theksojmë se, për analogji, krahasuar me procedurën me objekt të njëjtë të zhvilluar për vitin kaluar 2022, për të cilën u paraqitën ankesa pranë Komisionit të Prokurimit Publik për modifikimin e dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor, në procedurën e këtij

viti ka modifikuar tërësisht kriteret e kualifikimit për këtë procedurë krahasuar me vitin e mëparshëm. Sa më sipër, KPP konstaton se në rishpalljen e kësaj procedurë kualifikimi, autoriteti kontraktor nuk ka vendosur kriteret kualifikimi.

Sa më sipër, gjykojmë se autoriteti kontraktor, nisur nga lloji i kësaj procedure prokurimi, kompleksiteti i saj, rëndësia dhe impakti që ka në jetën e njeriut, brenda diskrecionit të lejuar nga ligji, duhet të rishikojë kriteret e vecanta të kualifikimit në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik si dhe legjislacionit të fushës përkatëse, më qëllim që të sigurohet që ky shërbim do të realizohet nga subjekte të cilat kanë të gjitha kapacitetet e nevojshme për realizimin me përgjegjshmëri dhe saktësi të këtij shërbimi.

Akoma më tej, mënyra e hartimit të kriterëve ndikon drejtpërdrejt në fazën e vlerësimit të kësaj procedure prokurimi, duke kualifikuar ato operatorë të cilat kanë kapacitete e duhura ligjore për ushtrimin dhe realizimin e objektit të prokurimit.

III.1.6. Lidhur me pretendimet e ankimuesit “*apo do konsiderohen të dhënat e rregjistrimit që i përket vendit të origjinës, të paraqitura në fazën e aplikimit për rregjistrimin në Shqipëri (për shembull EPA Amerikane) ose DE (Departamenti Australian i Mjedisit) etj?? Kërkojmë sqarime në lidhje me këtë pikë*

Për këtë duhet ti rreferoliemi autorizimit/rregjistrimit në ECHA apo madje mund të shkojë shumë më poshtë dozës minimale të autorizuar në ECHA, nëse kjo është e ndryshme nga doza e autorizuar në vendin nga i cili vjen rregjistrimi?? Kërkojmë sqarime në lidhje me këtë pikë”, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se nga ana e autoritetit kontraktor nuk është dhënë asnjë sqarim për paqartësinë e ankimuesit. Pra rezulton, se në rastin konkret ndodhemi para kërkit për sqarime mbi mënyrën se si do të ofertohej në procedurën e prokurimit objekt-ankimi. Autoriteti kontraktor ka detyrimin të sqarojë ofertuesit për çdo kriter në mënyrë të detajuar dhe duhet përcaktojë qartë dhe saktë dokumentacionin e nevojshëm që kërkohet për plotësimin e kësaj kërkesë. Gjithashtu autoriteti kontraktor duhet përcaktojë dhe argumentojë qartë arsyen e vendosjes së këtyre kërkesave.

Kriteret e kualifikimit duhet të jenë të qarta, të sakta dhe të mirëpërcaktuara nga autoriteti kontraktor me qëllim që të jenë sa më të kuptueshme jo vetëm për operatorët ekonomikë të interesuar për të qënë pjesëmarrës, por edhe komisionin e vlerësimit të ofertave në mënyrë të tillë që procesi i vlerësimit të mos kryhet me subjektivizëm, por të vendosë në situatë të barabartë edhe për personat me aftësi të kufizuara, duke mos penguar kështu pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi.

Për sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të sqarojë ankimuesin lidhur me kërkesat e mësipërme dhe këto sqarime duhet të publikohen për t’u njohur nga të gjithë subjektet e interesuara, në përputhje me përcaktimet e nenit 75 të LPP-së.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar “2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar. 1.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit 5. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare”, Kërkojmë që ky kriter kualifikimi të modifikohet sipas pikës 2 të nenit 41 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit Publik”, i ndryshuar”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, për Lotin 5, në pikën 2.2/1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit 5**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

III.2.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.2.3. Në nenin 77, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërket nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërket operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër”.

III.2.4. Në nenin 43 pikat 1, 2 dhe 3 “Kërkesat për kapacitet ekonomik financiar” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërket operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

3. *Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

III.2.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim, si dhe hartimi i dokumenteve të tenderit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit të kriteret e veçanta për kualifikim kapaciteti ekonomik dhe financiar, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të *“Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit 5. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare”*, ndërsa në nenin 77, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, parashikohet shprehimisht se: *“Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”*. Ndërkohë në nenin 43 pikat 2 *“Kërkesat për kapacitet ekonomik financiar”* të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar, parashikohet se: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”*. Nga sa më sipër KPP, vëren se në tërësi kriteri i hartuar nga autoriteti kontraktor është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore konkretisht me nenin 77, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, si dhe nenin 43 pikat 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar.

Konkretisht me vendosjen e kriterit lidhur me xhiron e kërkuar ku *vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit 5*, KPP gjykon se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij të vendosë kriterin e kualifikimit brenda diskrecionit të lejuar nga ligji. Konkretisht, për procedurat mbi kufirin e lartë monetar ligjvënsëi parashikon se *vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës*, pra ligjvënësi ka vendosur një nivel tavan për autoritetin kontraktor sa i takon vlerës që mund të kërkohet në rastin e xhiros, duke qënë kështu detyrim për autoritetin kontraktor për të mos kërkuar mbi këtë tavan të parashikuar në ligj. Dispozita ligjore ka për qëllim të ndalojë autoritetet kontraktore të

kërkojnë një vlerë mbi maksimumin e lejuar, por i lejon këto të fundit të hartojnë kriterin e kualifikimit duke kërkuar një vlerë brenda diskrecionit të lejuar nga ligji. Ligjvënësi shprehimisht kërkon që *vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë*, pra nuk ndalon autoritetin kontraktor që të kërkojë në kriteret e kualifikimit një vlerë më të vogël se *dyfishi i vlerës së parashikuar të kontratës*, pra në rastin konkret, për procedurën objekt shqyrtimi qëllimi i kriterit nuk është penalizimi i operatorëve ekonomikë që mund të kenë xhiro që e tejkalojnë vlerën minimale të kërkuar nga autoriteti kontraktor, por brenda diskrecionit të lejuar nga ligji, autoriteti kontraktor ka përcaktuar një vlerë minimale.

Sa më sipër, gjykojmë se kriteri në lidhje me xhiron vjetore është hartuar në përputhje me nenin 77, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 43 pikat 2 “Kërkesat për kapacitet ekonomik financiar” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “NRG” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-66562-04-19-2023, me objekt: Loti 5 “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Fier”, me fond limit 21.673.080 lekë (pa tvsh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 22.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “NRG” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri